



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPËSTINA VUÇITRRI


02 Nr. / Nr. 1001 / 18

Nr. i Sq. / Data

Data / Datum 01.08.2018

VUSHTRRI - VUÇITRRI


REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, si dhe nenin 2, 3 dhe 4 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit 02 nr. 975/18 dt. 31.07.2018 në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Organizatës “Qatar Charity” me seli në Prishtinë, Kryetari i Komunës merr këtë:



V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për përgatitje të listës së jetimëve në Komunën e Vushtrrisë për ndihmë, nga Organizata “Qatar Charity” me seli në Prishtinë, në këtë përbërje:
 - 1.1 Fadil Bahtiri, Zyra e Kryetarit,
 - 1.2 Naim Ferizi, Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
 - 1.3 Vildane Mulaku, Shoqata e Familjarëve të Martirëve
2. Komisioni në fjalë do të përgatis listën me emrat e fëmijëve jetim nga Komuna e Vushtrrisë të cilëve Organizata “Qatar Charity” do të iu ndaj ndihma financiare dhe ndihma tjera. Fëmijët duhet të jenë të moshës deri në 12 vjet (nga v. 2006-2018). Jetim konsiderohet fmiu të cilit i ka vdekur njeni apo të dy prindërit. Gjithashtu në listë duhet të shënohet adresa dhe nr. kontaktues i kryefamiljarit të fmiut jetim.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: Drejtorit për Shërbime Publike, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe nenin 7 të Rregullores 01nr. 189/15, dt. 29.09.2015 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë, Kryetari i Komunës jep këtë:

URDHËRESË

1. Urdhëroj zyrtarët kompetent të këtyre drejtorive: Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Shërbimeve Publike, Prokurim Publik, Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Buxhet dhe Financa, që mos të iu ofrojnë shërbime komunale administrative atyre gjeneruesve të mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë të cilët nuk i kanë paguar dy këste të njëpasnjëshme të tarifës për mbeturina.
2. Drejtorët e drejtorive nga pika paraprake do të i njoftojnë zyrtarët kompetent në kuadër të drejtorisë me këtë urdhëresë si dhe do të mbikëqyrin zbatimin e saj.
3. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Urdhëresa iu dërgohet: drejtorëve të drejtorive nga pika 1, si dhe arkivit të sekretarisë.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPSTINA VUCHITRA

02 Nr. / Br 1008/18

Nr. i fq. / Br. sh


Data: / Datum 02.08.2018

VUSHTRRI - VUCHITRA



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës nr.1016978, dt. 17.07.2018 në shumë prej 54.00 € (pesëdhjetekatër euro) për shpenzime të krijuara - ushqim në DPH "Te Enveri" në Vushtri, për punëtorë të angazhuar në bartjen e inventarit nga objekti i vjetër i komunës në objektin e ri.
2. Pagesa të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Arsim, në numër të llogarisë bankare të paraqitur në faturë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Arsim dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafa Tahiri




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - ОПШТИНА ВУШТРИ

02 Nr. / Br. 1009/18

Nr. / Sq. / Br. sh.

Data: / Datum 02.08.2018

VUSHTRRI - ВУШТРИ





REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe nenin 3, pika "b" të Memorandumit e Mirëkuptimit, Nr. 556/18 dt. 19.04.2018, ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara mbi Vendbanimet Njerëzore (UN-Habitat), PAX dhe Komunës së Vushtrrië, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

1. Formohet grupi punues për hartimin e Planit të Pjesëmarrjes së Qytetarëve në procesin e vendimmarrje në Komunën e vushtrrië në këtë përbërje:
 - 1.1 **Blerim Zhabari** - Udhëheqës i Zyrës së Informimit - kordinator
 - 1.2 **Ismet Gashi** - Zyrtar ligjor, anëtar;
 - 1.3 **Gazmend Morina** - Zyrtar për Integritet Evropian, anëtar;
 - 1.4 **Liridon Lahu** - Udhëheqës i shërbimit për punë të përbashkëta, anëtar;
 - 1.5 **Bujar Klinaku** - Zyrtar i Sekretarisë së Kuvendit Komunal, anëtar;
 - 1.6 **Xhavit Mehmeti** - Shërbyes civil në Drejtorinë për Administratë, anëtar;
 - 1.7 **Remzije Zekolli** - Zyrtare për Barazi Gjinore, anëtare
2. Grupi punues, në bashkëpunim të ngushtë me Këshilltarin e UN-Habitat për Qasjen e Qytetarëve në Vendimmarrje do të hartojnë Planin për Pjesëmarrjen Qytetarëve në Proceset Vendimmarrëse në nivel lokal duke e harmonizuar me bazën ligjore ekzistuese dhe duke ndikuar në avancimin e demokracisë funksionale.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: Anëtarëve të Komisionit, dhe Arkivit të Sekretarisë.


Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIŠË - OPŠTINA VUČITRA

02 Nr. / Sr. 1010 / 18

Nr. i fq. / Br. sh. _____

Data: / Datum 02.08.2018

VUSHTRRI - VUČITRA



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës nr.0107536, dt. 27.07.2018 në shumë prej 106.70 € (njëqindegjashtëeuroshatëdhjetë cent) për shpenzime të krijuara - ushqim në DPH “Prestigj” në Vushtrri, me mysafirë nga Shqipëria etj. me rastin e mbajtjes së manifestimit “Ditët e Diasporës”, nga data 23 deri 31 07.2018.
2. Pagesa të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, në numër të llogarisë bankare të paraqitur në faturë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.




Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA OF KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPSTINA VUSHTRRI
Ud Nr / Dr: 1029/18
No Lp / Pril:
Datim / Datum: 08.08.2018
SHENJTIKLA: 200208





REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, dhe nenin 67, “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për hartimin e Programit të Banimit për Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2019 – 2021.
2. Në përbërje të komisionit caktohen:
 - 2.1 Sylejman Meholli, kryesues i komisionit
 - 2.2 Ismet Gashi, anëtar
 - 2.3 Isa Latifi, anëtar
 - 2.4 Azize Krasniqi, anëtare
 - 2.5 Naim Ferizi, anëtar
3. Komisioni në përbërje të cekur në pikën paraprake do të përgatis programin e banimit për kategoritë e caktuara të qytetarëve – për familjet dhe individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike të i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave.
4. Programi duhet të përmbaj dhe rregulloj çështjet që janë në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për financimin e programeve të veçanta të banimit si dhe akteve nënligjore të cilat e rregullojnë këtë problematikë duke përfshi edhe koston financiare për financim të programit.
5. Komisioni gjatë punës së tij do të bashkëpunoj me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me OJQ të fushës përkatëse dhe drejtoritë komunale sipas nevojës.
6. Programi duhet të përgatitet dhe dërgohet në KPF dhe kuvend për miratim gjatë vitit 2018.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
8. Vendimi iu dërgohet: anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri




REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRI - КОМУНА ВУШТРИ

1053/18

22.08.2018




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës nr.0033911 dt. 27.07.2018 në shumë prej 43.00 € (katërdhjetëtri euro) në llogari të DPT “Margarita” në Vushtri, për blerje të një dhurate – orë dore për znj. Nagjije Mustafa me rastin e pensionimit të saj në QKMF - Vushtri.
2. Pagesa e mjeteve në shumën e cekur në pikën paraprake të bëhet nga buxheti i komunës – mallra dhe shërbime i Qendrës së Mjekësisë Familjare.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Shëndetësisë dhe Përkujdesje Sociale dhe Arkivit të Sekretarisë.




Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për raportim të zbatimit të Planit të Integritetit për Komunën e Vushtrrisë për periudhën kohore 2016-2019, në këtë përbërje:
 - 1.1 Haki Maloku, kryesues – përgjegjës i sekretarisë
 - 1.2 Ismet Gashi, anëtar – zyra ligjore
 - 1.3 Blerim Zhabari, anëtar – zyra për informin
 - 1.4 Isak Hyseni, anëtar – shoqëria civile
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake do të i bëjë analizë të hollësishme të gjitha pikave të përcaktuara në plan: sa janë realizuar objektivat e parapara, si dhe sa i kanë realizuar bartësit e aktiviteteve detyrat dhe obligimet e përcaktuara. Lidhur me punën e tij komisioni do të hartoj raport me shkrim për kryetarin e Komunës për kohën për të cilën do të kërkohet. Ndërsa për organet dhe organizatat tjera të interesuara, raportimi do të bëhet nga zyrtari i komunës i autorizuar me vendim të kryetarit të komunës.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi iu dërgohet: anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.

